



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 3), dhe 18), dhe në pajtim me nenin 7, paragrafi (1), pika 4), neni 24 dhe 41 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14 dhe 153/15), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, miratoi

P O L I T I K Ë

politikë për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore të Republikës së Maqedonisë¹ (tekst i konsoliduar jozyrtar)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin në vijim: Banka Popullore) menaxhon dhe investon rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin në vijim: rezervat valutore).
2. Rezervat valutore kanë rol kryesor në sigurimin e aftësisë së vendit për të kompensuar disbalancat neto valutore në bilancin e pagesave dhe në ruajtjen e besueshmërisë në politikën monetare dhe të kursit të këmbimit.

Gjatë menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore, merret parasysh niveli adekuat i rezervave valutore, i cili vlerësohet nga Banka Popullore, duke marrë parasysh të gjitha burimet dhe përdorimet e mundshme të rezervave valutore, si dhe vlerësimin e cenueshmërisë makroekonomike ndaj goditjeve të jashtme.

Banka Popullore menaxhon dhe investon rezervat valutore për qëllimet e mëposhtme:

- Mbështetja dhe ruajtja e besimit në politikën e kursit të këmbimit të denarit, duke përfshirë ndërhyrjet në tregun e brendshëm valutor dhe ruajtjen e kushteve stabile në tregjet e brendshme financiare;
- Sigurimi i besimit të tregjeve për kryerjen në kohë dhe të rregullt të obligimeve financiare të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit.
- Sigurimi i valutës së huaj për nevoja operationale;

¹ Teksti i konsoliduar i Politikës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 223/15), Politika për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.141/2016), Politika për ndryshimin dhe plotësimin e menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.132/22) dhe Politika për ndryshimin dhe plotësimin e menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.211/24).

- Investimi efikas i fondeve të tepërta pas ndarjes së fondeve të parashikueshme të likuiditetit, fondet për ndërhyrje dhe fondet për kujdes;
- Sigurimi i fondeve për mbrojtje nga goditjet e bilancit të pagesave gjatë krizës.

II.QËLLIME GJATË MENAXHIMIT DHE INVESTIMIT TË REZERVAVE VALUTORE

3. Kjo politikë e vendos kornizën institucionale për realizimin efektiv dhe efikas të qëllimeve gjatë menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore. Ato qëllime janë: siguria, likuiditeti dhe përfitimi, të cilat janë me prioritet të njëjtë.

- Sigurimi i rezervave valutore, gjegjësisht ruajtja e vlerës së tyre, është qëllimi më i rëndësishëm gjatë menaxhimit dhe investimit. Në këtë kuptim, ky qëllim po realizohet me kufizimin e rrezikut të kredisë, të interesit, të valutës dhe rrezikut operativ;
- Likuiditeti i rezervave valutore nënkupton disponueshmërinë e nivelit të përshtatshëm të fondeve për pagesën në kohë të detyrimeve të parashikuara dhe të paparashikuara nga rezervat valutore. Me qëllim të sigurohet likuiditeti i mjaftueshëm, rezervat valutore në pjesë më të madhe investohen në instrumente që tregtohen në tregun sekondar aktiv;
- Rentabiliteti, gjegjësisht realizimi i kthimit nga investimet, në pajtim me kufizimet e vendosura me ruajtjen e vlerës dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm, realizohet me qëllim të arrihet normë konkurruese tregu të kthimit të rezervave valutore, e përshtatshme me qëllimet e investimit dhe kufijtë e vendosur për rrezikun.

3-a. Gjatë menaxhimit të rezervave valutore mund të merret parasysh edhe angazhimi i Bankës Popullore lidhur me kontributin për ekonomi të qëndrueshme të gjelbër, rritjen e ndërgjegjësimin për ndryshimet klimatike dhe përgjegjësinë sociale, pa cenuar parimet e sigurisë, likuiditetit dhe përfitimit.

III. STRUKTURA E REZERVAVE VALUTORE

Portofoli i rezervave valutore

4. Për realizimin e qëllimeve të shumëfishta, dhe në varësi të kërkesave për likuiditet dhe periudhës së investimit, rezervat valutore shpërndahen në mënyrë operacionale në portofola të veçantë.

Struktura dhe madhësia relative e çdo portofoli përcaktohet në bazë të vlerësimit të likuiditetit të kërkuar për periudha të ndryshme kohore, me ç'rast duke marrë parasysh nivelin e duhur të rezervave valutore. Në kushtet kur niveli i rezervave valutore tejkalon detyrimet e jashtme të shtetit për pagesën e borxhit dhe nevojat e mundshme të likuiditetit në të ardhmen, një pjesë e fondeve mund të investohen në një afat më të gjatë, me qëllim të rritet kthimi.

Me qëllim optimizimi i menaxhimit me rezervave valutore, duke marrë parasysh nevojat e ndryshme për likuiditet në periudha të ndryshme kohore, çdo portofolë ka funksion të veçantë, llojet e lejuara të instrumenteve, tolerancë ndaj rrezikut dhe periudhë investimi. Portofolet që

kanë funksion për plotësimin e nevojave afatshkurtra të likuiditetit investohen në aktive afatshkurtra me likuiditet të lartë. Portofolet me periudhë më të gjatë investimi Banka Popullore i investon në investime me raport relativisht më të lartë të rrezikut dhe kthimit, në pajtim me parimet e diversifikimit të investimeve portofolë.

Në varësi të detyrimeve të jashtme të shtetit për shlyerjen e borxhit, nevojave të mundshme për likuiditet në të ardhmen, dhe duke pasur parasysh nivelin e duhur, rezervat valutore janë të ndara në tre portofolë:

- *Kapitali punues (portofoli operativ)*, i cili shërben për të përmbushur detyrimet operacionale, afatshkurtra të likuiditetit dhe ndërhyrjet e mundshme. Ky portofol ka periudhë investimi prej një muaji dhe rrjedhimisht investohet në instrumentet më likuide dhe më të sigurt. Para fillimit të çdo muaji, vlerësohet niveli i nevojave për likuiditet për atë muaj, duke përfshirë detyrimet e jashtme të shtetit për shlyerjen e borxhit dhe ndërhyrjet e mundshme në tregun valutor, dhe në bazë të kësaj përcaktohet niveli i kapitalit punues. Sipas nevojës, niveli i kapitalit punues përshtatet gjatë muajit;
- *Portofoli i likuiditetit*, i cili përbëhet nga fondet nga të cilat plotësohet kapitali punues (portofoli operativ), nëse ka nevojë dhe në të cilin transferohet teprica e fondeve të kapitalit punues (portofoli operativ). Qëllimi i këtij portofoli është të përmbushë të gjitha daljet kontraktuale dhe potenciale gjatë 12 muajve në vijim. Ky portofol investohet në instrumente financiare likuide, duke pasur parasysh qëllimin e ruajtjes së vlerës së tij në periudhë investimi prej një viti; dhe
- *Portofol investimi*, i cili mund të ketë periudhë investimi më shumë se një vit dhe që menaxhohet me qëllim të rritjes së kthimit të rezervave valutore, si dhe për mbulimin e detyrimeve të paparashikuara në afat më të gjatë për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe financiar të vendit. Ky portofol investohet në instrumentet financiare me rrezik më të lartë për shkak të realizimit të kthimit më të lartë të investimeve, megjithatë në pajtim me tolerancën e rrezikut të përcaktuar me këtë politikë. Në kuadër të portofolit të investimeve, një pjesë e caktuar e letrave me vlerë mund të klasifikohen si letra me vlerë të ruajtura deri në maturim. Shuma më e lartë e lejuar dhe maturimi i këtyre letrave me vlerë përcaktohet në Politikën e menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore, duke marrë parasysh nivelin e rezervave valutore në raport me nivelin adekuat të rezervave valutore të vlerësuar në Bankën Popullore.

Pa prishur funksionin e secilit prej portofoleve, instrumentet financiare brenda tyre mund të menaxhohen sipas tre modeleve të biznesit me qëllim sigurimin e hyrjeve të parasë dhe menaxhimit të rreziqeve financiare. Në varësi të modelit të biznesit, instrumentet financiare mund të mbahen për qëllimin e mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale, respektivisht për të ruajtur normë të kthimit të caktuar të interesit; për shkak të tregtimit aktiv dhe të shpeshtë për të përfituar nga ndryshimet në vlerën e tregut të instrumenteve; ose për qëllim të mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale me mundësinë e realizimit të fitimit nga ndryshimet në vlerën e tregut të instrumenteve.

Kriteret për përcaktimin e nivelit të portofolit, llojet e instrumenteve të lejuara, maturimin maksimal, klasifikimin e aktiveve financiare sipas modeleve të zgjedhura të biznesit, si dhe

portofolet e referencës përcaktohen në Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore. Niveli i portofolit të likuiditetit dhe investimeve rishikohet periodikisht në bazë të projeksionit të nevojave për likuiditet, nevojave të pritshme për valutë.

Ari, si portofol i veçantë, është në funksion të sigurimit të sigurisë dhe likuiditetit të rezervave valutore nëpërmjet diversifikimit të investimeve, duke pasur parasysh se ari paraqet aset të rëndësishëm në kushtet e paqëndrueshmërisë globale, ekonomike apo politike. Niveli dhe instrumentet në të cilat lejohet të investohet ari përcaktohet në Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

Struktura valutore bazë e rezervave valutore

5. Rezervat valutore investohen vetëm në valuta lehtësisht të konvertueshme të vendeve me tregje të thella dhe likuide të kapitalit.

Struktura valutore bazë e rezervave valutore është në pajtim me strukturën valutore nga:

- ndërhyrjet në tregun e brendshëm valutor;
- detyrimet e shtetit jashtë vendit;
- shkëmbimi tregtar i jashtëm i Republikës së Maqedonisë;
- nevoja tjera për likuiditet.

Struktura valutore bazë e rezervave valutore përcaktohet kur nga totali i rezervave valutore zbritet vlera e portofolit të arit.

Struktura valutore bazë e rezervave valutore dhe devijimi i lejuar nga struktura valutore bazë, me qëllim të diversifikimit të rrezikut dhe maksimizimit të kthimit, përcaktohen në Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

Shpërndarja strategjike e rezervave valutore dhe e portofoleve referencë

6. Shpërndarja strategjike e rezervave valutore dhe portofolet përkatëse të referencës përcaktohen në Rregullat për Menaxhimin dhe Investimin e Rezervave Valutore. Shpërndarja strategjike e portofolit të investimeve është në pajtim me mundësinë e maksimizimit të kthimit mesatar vjetor afatgjatë në nivele të ulëta probabiliteti të uljes së vlerës së tyre gjatë periudhës së investimit.

IV. LLOJET E FONDEVE

6. Banka Popullore mund t'i blejë dhe shesë instrumentet e mëposhtme financiare dhe të kryejë transaksionet e mëposhtme:

Ari – Banka Popullore ruan pjesë nga rezervat valutore në ari. Ari mund të ruhet në thesarin e Bankës Popullore ose jashtë vendit. Banka Popullore mund të kryen transaksione me ari në tregun e brendshëm dhe tregun ndërkombëtar, të si depozitave

të kolateralizuara dhe jo të kolateralizuara në banka dhe institucione financiare, si dhe të shkrin ari që nuk i plotëson standardet e tregut, në shufra ari.

Letrat shtetërore me vlerë të emetuara në valutë kombëtare dhe valutë të ndryshme nga valuta kombëtare, letra me vlerë të garantuara nga shteti dhe letra me vlerë të emetuara nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat shumëpalëshe të zhvillimit - blerja dhe shitja e letrave me vlerë të borxhit të emetuara ose të garantuara nga shtetet ose subjektet shtetërore, duke përfshirë qeveritë rajonale dhe vendore dhe agjencitë nga sektori publik ose institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat shumëpalëshe të zhvillimit.

Instrumentet e bankave dhe institucioneve financiare – vendosja e depozitave dhe blerja dhe shitja e obligacioneve të kolateralizuara, certifikatat e depozitave, letra tregtare dhe instrumente të tjera në tregun e parasë, të emetuara ose të garantuara pa kushte nga bankat dhe institucionet e tjera financiare që lejohen me Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

Transaksionet me instrumente derivative – blerja dhe shitja e instrumenteve derivative, për të cilat fonde bazë janë instrumentet financiare të lejuara në Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

Transaksionet klasike të repove të anasjellta dhe huadhënia e letrave me vlerë - huamarrja e parave dhe letrave me vlerë të siguruara me kolateral, ku letrat me vlerë që janë huazuar ose pranuar si kolateral i plotësojnë kriteret e lejuara në Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore dhe Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

Mjetet e huaja për pagesë - blerja dhe shitja e valutave dhe mjeteve të huaja për pagesë.

Obligacionet e korporatave – blerja dhe shitja e letrave me vlerë të borxhit të emetuara nga institucionet e huaja financiare.

Pjesët e aksioneve në fondet e investimeve – blerjen dhe shitjen e pjesëve të aksioneve në fondet e investimeve që janë të regjistruara jashtë vendit dhe për të cilin aktivi bazë janë instrumentet financiare të lejuara në Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

8. Lista e vendeve të lejuara ku mund të vendosen rezerva valutore, emetuesit e letrave me vlerë dhe institucioneve financiare me të cilat lejohet të lidhen transaksione gjatë menaxhimit të rezervave valutore, si dhe kufijtë sasiorë të ekspozimit përcaktohen në Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

9. Me qëllim që të forcohet kapaciteti institucional gjatë menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore, me propozim të Komitetit për investim, guvernatori mund të transferojë të

drejtën e menaxhimit dhe investimit të një pjesë të rezervave valutore të institucioneve të jashtme financiare.

10. Me qëllim të sigurohet menaxhim efikas të likuiditetit dhe transaksioneve të investimeve, mund të përdoren kredi nga bankat afariste dhe institucionet e tjera financiare në të cilat Banka Popullore ka vendosur investime, me qëllim që të zvogëlohet ose të tërhiqet ekspozimi i kredisë ndaj bankave afariste ose institucioneve të tjera financiare, për periudhë të barabartë me afatin e mbetur deri në maturimin e këtyre vendosjeve.

11. Drejtoria e Operacioneve të Tregjeve Financiare negocion dhe realizon transaksionet për të përmbushur objektivat të Politikës së menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore.

Drejtoria e Sistemeve të Pagesave, në koordinim me Drejtorinë e Operacioneve të Tregjeve Financiare hap dhe menaxhon llogaritë pranë bankave qendrore, bankave afariste dhe institucioneve të tjera financiare, në të cilët lejohet të investohen rezervat valutore.

V. RREZIKU I KREDISË DHE KUFIJTË E EKSPOZIMIT

12. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë monitorohet dhe kontrollohet përmes përcaktimit të vlerësimit minimal të kredisë afatgjate për emetuesit / institucionet financiare / instrumentet financiare më së paku BBB-/Baa3 ose identike, të ndarë nga agjencitë e njohura ndërkombëtare për vlerësim të kredisë, gjatë vendosjes dhe investimit të rezervave valutore. Gjithashtu, rreziku i kredisë monitorohet nëpërmjet treguesve të duhur të tregut. Në Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore, mund të përcaktohen kufij ekspozimi më të rreptë se sa lejohet ose të imponohen kufizime shtesë.

Bankat qendrore trajtohen si institucione, vlerësimi i të cilave është i barabartë me vlerësimin e vendit. Banka për Shlyerjet Ndërkombëtare (BIS) dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar janë të mënjanuara nga kriteret e vlerësimit të kredisë.

Ekspozimi maksimal i lejuar ndaj një banke afariste individuale nuk guxon të tejkalojë 10% të vlerës totale të tregut të rezervave valutore.

13. Drejtoria e Operacioneve të Tregjeve Financiare në bazë të rregullt monitoron emetuesit/institucionet financiare/ instrumentet financiare ku vendosen dhe investohen rezervat valutore në drejtim të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore dhe Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore dhe e njofton Komitetin e investimeve për zhvillimet e reja që vlerësohet se mund të kenë ndikim të rëndësishëm në situatën financiare dhe rrezikshmërinë e investimeve. Komiteti i investimeve dorëzon propozim deri te guvernatori për ndryshime të mundshme në kriteret dhe limitet sasiore të ekspozimit.

Nëse vlerësimet për rejtingun e kredisë bien nën pikën më të ulët të lejuar, Drejtoria e Operacioneve të Tregjeve Financiare e njofton Komitetin e investimeve. Në kushte të tilla,

vendosjet e reja ose investimet në instrumentet përkatëse nuk lejohen, dhe Komiteti i investimeve dorëzon deri te guvernatori propozim për mirëmbajtjen e mëtejshme ose ndërprerjen e vendosjeve ose investimeve ekzistuese në kushte të favorshme tregu.

VI. RREZIQET E TREGUT, KUFIJT E EKSPOZIMIT DHE PARAMETRAT PËR TOLERANCË TË RREZIKUT

14. Rezervat valutore janë të ekspozuara ndaj rrezikut të interesit, të rrezikut të premisë së kredisë dhe rrezikut valutor. Rreziku i normës së interesit i referohet rrezikut të uljes së vlerës së tregut të rezervave valutore për shkak të lëvizjeve të pafavorshme të normave të interesit. Rreziku i premisë së kredisë i referohet rrezikut të uljes së vlerës së tregut të rezervave valutore për shkak të zgjerimit të shtrirjes së kredisë në raport me letrat shtetërore me vlerë pa rrezik për shkak të përkeqësimit të kushteve të përgjithshme të kredisë ose për shkak të përkeqësimit të pozicionit kreditor të një emetuesi të caktuar. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit dhe rrezikut të premisë së kredisë duhet të sigurojë maksimizimin e kthimit të pritur, me kufizimin e probabilitetit për ulje të vlerës së tregut të rezervave valutore në 1% në nivel të besimit prej 95% gjatë një periudhe investimi prej një viti, gjegjësisht kthim pozitiv gjatë një periudhe investimi prej dy vitesh.

Niveli i pranueshëm i rrezikut zbatohet në Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore duke përcaktuar portofolet e referencës, kohëzgjatjen e modifikuar bazë, shmangie nga kohëzgjatja e modifikuar bazë, si dhe buxheti i rrezikut, i cili është për menaxhim aktiv nga menaxherët e portofolit për të fituar një kthim të arsyeshëm më të lartë se kthimi i portofolit të referencës. Buxheti i rrezikut shprehet si niveli i mundshëm i pranueshëm i mosrealizimit të kthimit, kundrejt kthimit të portofolit të referencës dhe shprehet si kufijtë e pozicioneve të marra. Buxheti i rrezikut shpërndahe ndërmjet menaxherëve të portofolit të brendshëm dhe të jashtëm.

Rreziku valutor i referohet rrezikut të uljes së vlerës së tregut të rezervave valutore, të matur në lidhje me strukturën bazë të valutës, për shkak të shmangies nga struktura bazë valutore dhe ndryshimi negativ në marrëdhëniet ndër-valutore. Nuk pritet që ekspozimi ndaj rrezikut të valutës do të tejkalojë nivelin e rezervave të rivlerësimit për diferencat e kursit të këmbimit.

Ekspozimi i arit ndaj rrezikut të çmimit dhe valutës mbulohet nga rezervat e rivlerësimit të arit.

VII. RREZIKU OPERATIV

15. Rreziqet e brendshme operationale në procesin e menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore do të kontrollohen nëpërmjet:

- Vendosja e një ndarje të duhur të përgjegjësi ndërmjet drejtorive dhe njësive të përfshira në procesin e menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore, përkatësisht në: realizimi i transaksioneve, monitorimi i harmonizimit me kufijtë e ekspozimit dhe kërkesat rregullatore,

matja e realizimeve, njoftimi, shlyerja dhe të dhënat e kontabilitetit;

- Caktimi i përgjegjësive dhe detyrave specifike dhe të përcaktuara qartë për çdo drejtori dhe njësi;
- Respektimi i kodit të etikës, i cili vlen për punonjësit në menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore;
- Sigurimi i teknologjisë së duhur të informacionit për të mbështetur operacionet për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

VIII. NDARJA E PËRGJEGJËSIVE

16. Këshilli i Bankës Popullore është përgjegjës për kontrollin e harmonizimit të menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore në pajtim me Ligjin e Bankës Popullore dhe Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

17. Këshilli ekzekutiv i Bankës Popullore miraton Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

Këshilli ekzekutiv i Bankës Popullore miraton vendim për formimin e Komitetit për investim.

Komiteti për investim është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Rregullave për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore, si dhe për monitorimin dhe mbikëqyrje të të gjitha proceseve të menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore.

18. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm kryen mbikëqyrje të harmonizimit të procedurave të brendshme, roleve dhe përgjegjësive në procesin e menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore me Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore dhe Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore dhe paraqet raporte drejtpërdrejt në Këshillin e Bankës Popullore.

Drejtorja e Operacioneve të Tregjeve Financiar është përgjegjëse për ruajtjen e strukturës organizative dhe kontroleve të brendshme efektive, të cilat mundësojnë menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore në pajtim me Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore dhe Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

Drejtorja për Sistemet e Pagesave është përgjegjëse për ruajtjen e strukturës organizative dhe kontroleve të brendshme efektive që mundësojnë realizimin në kohë dhe efikas të të gjitha operacioneve në sfond që lidhen me menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

IX. NJOFTIM PËR UDHËHEQËSINË

19. Drejtoria e Operacioneve të Tregjeve Financiare raporton çdo muaj Komitetin e Investimeve për strukturën e portofolit të rezervës valutore, profilin e rrezikut, kushtet e tregut, kthimi total në datën e raportimit, si dhe për rreziqe të caktuara operationale dhe

veprime korigjuese. Pasi që Komiteti i Investimeve do të shqyrton raportin mujor, e dorëzon deri te Këshilli ekzekutiv.

Drejtoria e Operacioneve të Tregjeve Financiare përmes Komitetit për Investime i dorëzon raporte tremujore Këshillit të Bankës Popullore për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore. Raporti përmban rishikim të vendosjes aktuale dhe investimi i rezervave valutore, duke përfshirë strukturën valutore, strukturën e instrumenteve, kohëzgjatjen e modifikuar dhe ekspozimin e kredisë. Raporti përfshin gjithashtu rezultatet e investimeve, gjegjësisht kthimin total dhe kthimin nga menaxhimi aktiv me portofolion.

Drejtoria e Operacioneve të Tregjeve Financiare, përmes Komitetit për investime, paraqet raport vjetor deri te Këshilli i Bankës Popullore për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore. Raporti përmban rishikim të vendosjes dhe investimit aktual të rezervave valutore, duke përfshirë edhe strukturën e valutës, strukturën e instrumenteve, kohëzgjatjen e modifikuar dhe ekspozimin e kredisë. Raporti përfshin gjithashtu rezultatet e investimeve, gjegjësisht kthimin total dhe kthimin nga menaxhimi aktiv i portofolit. Ky raport vjetor është pjesë e Raportit vjetor të Bankës Popullore.

Drejtoria për Auditimin e Brendshëm në baza vjetore dorëzon raport për harmonizimin e proceseve dhe procedurave të brendshme me Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore dhe Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore.

X. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

20. Me hyrjen në fuqi të kësaj politike, pushon të vlejë Politika për ruajtjen dhe menaxhimin me rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 126/11 dhe 26/14).

21. Kjo politikë hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe do të zbatohet nga 1 janari i vitit 2016.

Po.nr.

**Guvernatori
dhe kryesuesi i Këshillit
të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë,**